



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

V E N D I M

Nr. 628 , datë 10.10.2024

P Ë R

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.109,
DATË 15.2.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË
SË SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË E TË BORDIT
TË AKREDITIMIT DHE PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE
PËR PROCESET E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN
E LARTË”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 14, 15 e 106, të ligjit nr.80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në vendimin nr.109, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesa e mëposhtme:

a) Shkronja “a”, e pikës 10, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) vlerësimin e jashtëm të cilësisë për akreditimin e parë dhe periodik të institucioneve të arsimit të lartë e të programeve të studimit që ato ofrojnë, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”;

b) Pas pikës 34 shtohet pikat 34/1, me këtë përmbajtje:

“34/1. Procedurat e aplikimit sipas këtij vendimi, nëpërmjet portalit unik “e-Albania”, zbatohen pasi ministria përgjegjëse për arsimin të publikojë në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare përfundimin e procesit të

implementimit dhe datën e fillimit të funksionimit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, *SMIAL*. Deri në fillimin e funksionimit të sitemit, aplikimet do të bëhen me kërkesë pranë ASCAL-it.

Kërkesat dhe procedurat administrative, që janë në proces shqyrtimi nga ASCAL-i, deri në momentin e implementimit dhe funksionalitetit të Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Arsimit të Lartë, *SMIAL*, trajtohen dhe zhvillohen sipas dispozitave në fuqi të këtij vendimi, në kohën e paraqitjes së tyre.”.

- c) Në tabelën 2/c, bashkëlidhur vendimit, tarifa e përcaktuar në nënndarjen me nr.3 shfuqizohet.
2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

BELINDA BALLUKU

**MINISTRI I ARSIMIT
DHE SPORTIT**

OGERTA MANASTIRLIU

NR.PROT.5181/2
DATË 10.10.2024

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCISË KOMBËTARE TË FINANCIMIT TË
ARSIMIT TË LARTË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

